



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2020:153527

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05557652

KPPP.nr.520/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbarimore të kreditorit “NLB Prishtina” SH.A. me seli në Prishtinë, kundër debitorit NPT “Bleri” me seli në fshatin Grabovc i Epërm, Komuna e Obiliqit me pronarë N.M. për shkak të përmbarimit të paluajtshmërisë, jashtë seancës me datën 08.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas propozimit për përmbarim të kreditorit “NLB Prishtina” SH.A., kundër debitorit NPT “Bleri”.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës KPPP.nr.520/22 (PPP.nr.2695/20) në çështjen përmbarimore të kreditorit “NLB Prishtina” SH.A, kundër debitorit NPT “Bleri” vlerësoi kompetencën lëndore të gjykatës dhe gjeti se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas propozimit për përmbarim lidhur me këtë çështje.

Sipas nenit 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë për: *“të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*, dhe sipas Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se mjetet e rregullta të goditjes në procedurë përmbarimore janë prapësimi dhe ankesa, ndërsa duke u bazuar në faktin se në këtë rast çështja përmbarimore

zhvillohet sipas propozimit për përmbarim të paraqitur nga kreditori dhe se në rastin konkret nuk është paraqitur mjete juridik, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate për vendosje, për faktin se kjo gjykatë nuk është kompetente për të vendosur si organ përmbarues për lejimin e propozimit për përmbarim, por ka kompetence vetëm për të vendosur sipas mjeteve të rregullta të goditjes, të paraqitura kundër aktvendimin ose urdhrin të lëshuar nga përmbaruesit privat.

Ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykata dhe nenin 5 par 5 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore i cili përcakton se “ *Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbaruese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbaruesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e se cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbarimi.*”, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.520/22, datë 08.04.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate